


DRITARET



«Kurrë më nuk e kam
parë botën në mënyrë
të tillë.»





«Kur pyeta arkitektin tonë egzistojnë apo jo dritare që mbahen lehtë, ai vetëm qeshi dhe më tha: Nuk ka gjë më lehtë se kjo.»

PVC dritaret e bëjnë jetën më të lehtë

Dritaret janë thjeshtë këtu. Ato janë pjesë e të përditshmes kështuqë rallë na e tërheqin vëmendjen. Në përgjithësi nuk shohim vetë dritaret por shohim nëpërmjet tyre. Duke parë nga dritarja mendimet tonë shëtisin lehtësisht. Shohim pemët përpara shtëpisë tonë, rrugën, oborrin. Shohim se si gjethet e rëna ndryshojnë ngjyrën, si në pranverë natyra fillon përsëri të marrë frymë, si kalojnë njerëzit, çfarë ndodh tek fqinjët. Dritarja është hapje në botë.



Ose për shembull gjatë dimrit kur jashtë është shumë ftohtë, ndërsa ne kënaqemi me filxhanin e ngrohtë me çaj, e kemi të qartë se sa ndikojnë dritaret në ndjenjën tonë të kënaqërisë: kënaqemi duke parë në ajrin e ftohtë të rrezatuar dhe në ngrohtësinë e këndshme të shtëpisë.



Për shtëpi të këndshme

Vetëm atëherë kur ndërtojmë ose bëjmë rregullime në plan të parë dalin aspektet teknike të dritareve. Atëherë mendojmë se çfarë duhet të na sjell një dritare. Zbulojmë hollësitë siç janë hekurat dhe mbylljet. Këtu duhet edhe të vendosim për atë material i cili plotëson të gjitha kërkesat për dritaret, siç është për shembull izolimi optimal i ngrohjes për çdo lloj klime si në verë ashtu edhe në dimër.

PVC dritaret plotësojnë kërkesa të tilla të larta dhe ato e bëjnë jetën më të lehtë kur është fjala për gjëra të vogla. Profili VEKA me kualitet kurrë nuk duhet të lyhet më vonë gjë që Juve ju lehtëson pastrimin e tyre. Në fund të fundit me siguri keni diçka më të mirë për të kryer sesa të pastroni dritaret. Mund të rini lirisht në shtëpi, të lexoni ndonjë libër.





Kënaqësi në të menduar

Çdo ditë formojmë mjedisin tonë deri diku me vetëdije ose pa vetëdije. Për shembull kur rregullojmë apartamentin, ose kur thejstë në zyrë vendosim kalendarin ose kur nga e para rregullojmë tavolinën e punës. Ne e "dizenojmë" edhe veten çdo herë nga e para. Cilin xhup do të vesh sot? Shkon pulovra me çarapet? Më pëlqejnë apo jo akoma flokët e mia? Shpeshherë marrim vendime për format dhe ngjyrat, bëjmë zgjedhje dhe punojmë në stilin tonë personal të jetës.




Klasike – bindëse – dinamike Shembuj të dizeneve të ndryshme të VEKA sistemit

Kur ndërtoni ose rregulloni duhet të merrni shumë vendime: vendime shumë racionale të cilat do të karakterizojnë shtëpinë tuaj gjatë një kohe të gjatë, gjithashtu edhe vendime të cilat kanë të bëjnë me shijen tuaj. Kjo mund të sjell shumë kënaqësi sepse e kemi në natyrë që të jemi kreativë dhe të provojmë gjithmonë diçka të re. Me sistemin VEKA të dritareve mundimi i mirë i zgjedhjeve bëhet kënaqësi e vërtetë, sepse programi i pasur ka zgjidhje përkatëse për çdo lloj

arkitekture – që nga stili tradicional deri tek ai modern, nga rustikali deri tek eleganti, nga trendi deri tek i lirshmi, dhe të gjitha këto si pasojë e përshtatshmërisë së profilave dhe mbylljeve. Ndërmjet më shumë se 1.600 profilave, të shiritave dhe të pjesëve të tjera për linja të veçanta të sistemit me siguri do të gjendet zgjidhja e vërtetë për dritaret Tuaja të reja.

I doni harqet?

Në arkitekturën individuale nuk janë të gjitha me linja të drejta. Shumë ndërtesa të vjetra të magjepsin për shembull me dritaret e veta individuale me harqe të dukshme të kthyer. Gjatë rinovimit të ruhet karakteri i shtëpisë është detyrë e cila kërkon sy të mirë për hollësitat dhe ndjenja shumë të holla. Por edhe në arkitekturën e sotme format klasike kryesore siç janë dritaret me harqe të kthyer ose me harkun me majë kanë vendin e tyre të fortë. Planifikuesit kreativë shumë shpesh përdorin konstrukcionet simetrike dhe asimetrike të trekëndëshit kulmit. Me ndihmën e profilave VEKA të dritareve pa problem mund të realizohen edhe format më të jashtëzakonshme.



Më shumë ngjyra në jetë

Koha kur PVC dritaret ishin vetëm të bardha ka kohë që ka kaluar. Si do të ishte sikur të vendosnit ngjyrën tuaj më të preferuar ose ti jipni pamje rustikale të drurit. Ose ndoshta me dy ngjyra me sipërfaqen e përbrendshme të bardhë? Pa marrë parasysh se për cilën të vendosni profili VEKA me kualitet me ngjyra thjeshtë ju sjellin kënaqësi.




Dashuria është tek hollësitat

Zemra lidhet me gjëra të vogla. Gëzimi në fytyrën e saj kur qesh. Ose mënyra se si e thekson emrin e saj. Sa më shumë e njohim dikë aq më shumë i kemi të afërta hollësitat që përbëjnë një person.

Ju duhet që me vite të tëra të kënaqeni me dritaret Tuaja. Prandaj duhet që edhe këtu të keni vëmendjen tek gjërat e vogla të cilat e bëjnë jetën më të bukur. Të marrim për shembull shiritat zbukurues.

Ato i japin fasadës karakter të veçantë, ndërsa brenda në shtëpi krijojnë atmosferë të veçantë të këndshme.

Ndërmarrja Juaj e specializuar për VEKA profila njehtë të gjitha variacionet dhe përpunimet në VEKA programin të shiritave i cili jep një sërë tipash ndërtesues: shirita instalues, ngjithës dhe ndarës.



- 1. shirita instalues:**
zgjidhje ideale për mirëmbajtje të thjeshtë
- 2. shirita ngjithës me profila special të brendshëm:**
variacioni me harxhime të pakta me pamje klasike
- 3. shirita ndarës:**
ndërtime ekskluzive me kërkesat më të larta

Le t'Ju këshillojë eksperti Juaj për dritare. Me qëllim që të fitohet një ndjenjë e përgjithshme harmonike duhet të kihet sy me përvojë për dimensionet dhe masat.



«Unë dua të verdhën,
mami të kuqen, ndërsa
babi ngjyrën blu.»



«Çfarë është kjo?
Ka dy krahë, dhe na
ruan shumë mirë?»

Kualitet pa kompromis

Dritarja duhet që gjatë shekullit të vetë të durojë (dhe të mbajë) shumë: erën dhe shiun, breshërin, vapën dhe të ftohtin e madh. Gjatë verës ruan freskinë, gjatë dimrit brenda ri ngrohtësia e këndshme. Dritaret e profilit VEKA ruajnë jo vetëm klimën e mirë por edhe portofolin Tuaj sepse karakteristikat e shkëlqyera izoluese i ulin shumë harxhimet Tuaja të ngrohjes. Kështu do të mbeuten akoma më shumë para për gjëra më të rëndësishme. Dhe kjo është gjithashtu edhe ekologjike.

Përveç kësaj, VEKA profilat janë shumë rezistues në ndikimet e motit për shkak të materialeve të përdorura me kualitet të lartë dhe të përpunuara me kualitet. Kjo gjë vërtetohet nga kontrollat e shpeshta si dhe çertifikata të instituteve të njohura internacionale.



Siguria e rritur

Shtëpia Juaj Ju ruan Juve dhe familjen Tuaj. Dritaret janë elementi më i rëndësishëm i kësaj mbrojtjeje. Prandaj gjatë zgjedhjes kini vëmendjen tek kualiteti. Dritaret e bëra nga VEKA profili janë shumë stabile dhe mund të mbajnë ngarkesa të mëdha – që në përpunimin kryesor. Me ndihmën e hekurave speciale, të xhamave dhe dorezave ato mund të sigurohen akoma më shumë nga thyerjet – dhe sipas rregullave më të rrepta të sigurisë, dhe të gjitha këto me qëllim që Ju të ndiheni plotësisht të sigurtë.



Qetësia kënaq

Pas ditës së lodhshme njeriu nuk do të ketë në shtëpi asnjë gjë tjetër përveçse qetësisë. Për fat të keq mjedisi që na rrethon nuk na e lejon një gjë të tillë gjithmonë. Dritaret e izoluar nga zhurma e çojnë kualitetin e banimit dhe ndalojnë pasojat e mundshme të bëra nga shqetësimet dhe zhurma.

VEKA profili që në përpunimin e parë kanë izolim të lartë të zhurmës. Duke u varur nga intenziteti i zhurmës ka edhe mundësi të tjera optimale – që ga xhamat speciale deri tek xhamat e këndeve – VEKA programi u tregua në të gjitha klasat e izolimit të zhurmës.



Këshillat e ekspertëve

VEKA SISTEMI
· kualiteti i lartë
· partner i fortë
· servis optimal
· zgjidhje të përsosura

Shtëpia është diçka më shumë se pasuri e palëvizshme, ajo është shtëpia Juaj. Prandaj gjatë ndërtimit dhe rregullimit rëndësi të madhe ka mirëbesimi. Dhe këtu të gjitha varen nga siguria e partnerit. Ndërmarrja Juaj e specializuar për VEKA profila do Ju këshillojë me angazhim dhe me kompetenca për të gjitha pyetjet që kanë lidhje me dritaret. Ajo mbështetet në kualitet të verifikuar të sistemeve të njohura të profilit të firmës VEKA e cila është ndërmarrje udhëheqëse në botë kur bëhet fjalë për teknologjinë e bërjes së dritareve. Nga VEKA profili deri tani janë bërë më shumë se 100 milionë dritare dhe dyer.

Me llojshmërinë e sistemit i cili mundëson liri të plotë në krijimin individual të dritareve njëlojja në të kënaqur prodhuesit e dritareve, arkitektët dhe të gjithë ata që kanë ndërtuar shtëpitë. Binduni edhe vetë tek përparësitë e VEKA sistemit – dhe do ta shihni botën me sy të tjerë.

